



Republika e Maqedonisë së Veriut

Komuna e Bogovinës

Nr.ark. 08-2351/1

Data:24.08.2023

**Në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim në mes të Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë-Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe në bazë të aktiviteteve të planifikuara në suaza të projektit për bashkëpunim ndërkuftar për mbrojtje nga zjarret–Cross Border “FIRESHIELD”, Kryetari I komunës së Bogovinës shpall:**

## **SHPALLJE PUBLIKE**

### **Për zgjedhje të kandidatëve për trajnim për zjarrfikës**

Publikohet Shpallje publike për zgjedhje të kandidatëve për trajnim për zjarrfikës për nevojat e projektit Cross Border-“FIRESHIELD”, edhe atë:

1. Zjarrfikës- ( 5 ekzekutorë).

Kandidatët për zgjedhje për trajnim për zjarrfikës paraqiten në Shpalljen publike duke mbushur aplikacionin dhe duke dorëzuar dëshmi për plotësimin e kushteve të shpalljes.

Kryetari me Aktvendim formon Komision për selektim, e cila në afat prej 8 (tetë) ditësh nga kalimi I afatit për aplikim bën kontrollimin e dokumenteve të detyrueshme për plotësimin e kushteve të shpalljes.

Pas kompletimit të dokumenteve , Komisioni për selektim bën verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve.

Nëse gjatë verifikimit vërtetohet se dëshmia është e rreme , Komisioni e refuzon aplikimin.

Selektimi I kandidatëve bëhet përmes kriterëve të qarta dhe transparente, të përshkruara nga Kryetari I njësisë për vetqeverisje lokale.

Komisioni për selektim ranglistën ia dorëzon kryetarit , I cili përzgjedh në afat prej 15 ditësh.

Pas selektimit të parë nga ana e Komisionit bëhet edhe intervista me kandidatët me çka kryhet edhe përzgjedhja finale e kandidatëve.

Kandidatët e interesuar duhet ti plotësojnë këto kushte si në vijim:

**Kriteret :**

1. Kandidati duhet të jetë shtetas i R.M.V.
2. Të ketë mbushur 18 vjet ( moshë madhore),
3. Të ketë të kryer shkollën e mesme ,
4. Kandidatët për trajnim duhet të jenë të shëndetshëm dhe të aftë psikofizikisht , e vërtetuar nga institucioni shëndetsorë në pajtueshmëri me ligjin,
5. Me vendim të prerë gjyqësorë të mos jetë i dënuar për moskryerje të profesionit, detyrës apo veprimtarisë ,
6. Patentë shoferi- (patenta C do të llogaritet si përparsi).

**Kompetencat e përgjithshme:**

- Zgjidhja e problemeve dhe vendosja për punët në rrethin e vet punues,
- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- realizim të rezultateve,
- të punuarit me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegje strategjike
- orientimi drejt palëve të prekura dhe
- udhëheqje.

**Dokumentet e nevojshme:**

- CV (Biografija)
- Letër motivimi
- Fletë aplikimi
- Diploma e arsimit të mbaruar
- Dokument me të cilin dëshmohet se kandidati i plotëson kriteret e lartpërmendura (1-6)

Vërejtje: Kandidatët e interesuar duhet dokumentet e dorëzuara ti kenë detyrimisht në origjinal ose të notarizuara.

Fletë aplikimi për Shpalljen publike mund të shkarkohet në webfaqen e komunës, <https://komunabogovine.gov.mk/> ose në arkivin e komunës së Bogovinës .

### **Përshkrimi I procesit të trajnimit dhe detyrimet e kandidatëve të selektuar**

Trajnimi do të zgjasë (orë mësimore):720 orë nga të cilët 620 orë janë pjesa teorike dhe 100 orë pjesa praktike.

Kandidatët gjatë pjesës teorike do të kenë mundësi të ndjekin lëndë nga arsimit i përgjithshëm, teori profesionale, nga lëmi të veçanta profesionale dhe praktikë speciale, gjegjësisht gjithsej 19 lëndë mësimore/module.

Vlersimi dhe arritjet e kandidatëve në profilin arsimor –zjarrfikës profesional do të bëhen në kontinuitet të mësimit. Gjatë mbarimit të secilit modul gojarisht dhe me shkrim do të testohen si dhe aftësitë , shkathtësitë për çdo modul.

Secila programë mësimore /modul do të vlerësohet me notë prej 1deri më 5.

Pas realizimit të suksesshëm kandidatët do të japin provim të specializuar sipas programeve të provimeve që i punon CSOO dhe i sjell Ministria e arsimit dhe shkencës.

Provimi final përfshin:

Pjesa teorike me test –provim me shkrim i diturive

Pjesa praktike duke zgjidhur një rast, kontrollë i aftësive të fituara gjatë ushtrimeve praktike.

Provimi realizohet sipas komisionit të provimit me programë të provimeve.

Pas dhënies me sukses të provimit final kandidatët fitojnë **DIPLOMË PËR ARSIMIM TË SPECIALIZUAR - ZJARRFIKËS PROFESIONAL**.

Afati për aplikim është 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e shpalljes së tij.Kushtet e theksuara në Shpallje , kandidatët duhet ti plotësojnë në momentin e aplikimit.

Fletë aplikimi me dëshmitë dorëzohet në zarf të mbyllur në adresë: Komuna e Bogovinës Rr. "101" pn. me titull: "Trajnim për zjarrfikës".

Personi për kontakt: Nazmije Aliji

**Aplikimet e pakompletuara dhe jo në kohë nuk do të merren parasysh.**

Kryetari  
Besnik Emshi